



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Administratës

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202000834/2

Tiranë ___/___/2020

Lënda: Rekomandim përshpejtimi i procedurave dhe afateve të vendimmarrjes përfundimtare për shqyrtimin e vetëdeklarimit për legalizim nr.3940, datë 29.12.2014, të kryer prej ankueses ***.

Drejtuar: Drejtorit Vendor të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës,
Tirana-Veri

TIRANË

Për dijeni: Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës
Z.Artan Lame

TIRANË

Zj.***
Rruga "Stavre Ceca", Njësia Administrative nr.4

Adresa:

TIRANË

I nderuar z. Drejtor!

Institucioni i Avokatit të Popullit në procein e shqyrtimit të çështjes së prezantuar prej shtetasës ***, e cila ankohet ndaj Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Tirana-Veri, për mospërfundimin e procesit administrativ të shqyrtimit të vetëdeklarimit të kryer prej saj me nr.3940, datë 29.12.2014. Në procesin e shqyrtimit të kësaj çështjeje, Institucioni i Avokatit të Popullit, ka kërkuar Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Tirana-Veri., me shkresën nr.K3/K17-2 Prot, datë 06.08.2019, informacion dhe shpjegime rreth shkaqeve të cilat justifikojnë mospërfundimin e shqyrtimit të vetëdeklarimit nr.3940, datë 29.12.2014, të kryer prej ankueses zj.***.

Në përgjigje të kërkesës së Institucionit të Avokatit të Popullit, ju me Tuajën nr.8532/1 Prot, datë 03.10.2019, shpjegoni se keni marrë masa për verifikimin e rastit, gjendjes faktike në terren të ndërtimit informal, dhe se do të procedoni në vijim sipas legjislacionit në fuqi.

Bashkëlidhur Tuajës nr.8532/1 Prot, datë 03.10.2019, ju keni dërguar kopje (fotokopje) të akteve, shkresave të administruara në dosjen e krijuar për çështjen në fjalë.

Në këtë dosje, rezulton të jëtë administruar nga ana juaj:

- Deklaratë “Për përfshirjen në procedurat e legalizimit të ndërtimit pa leje dhe/ose shtesës në ndërtim me leje” e zj.***, administruar me nr.3940 prot, datë 29.12.2014;
- Çertifikatë familjare datë 09.12.2014, lëshuar prej Zyrës së Gjendjes Civile, Njësia Bashkiake nr.4, Tiranë;
- Fotokopje e kartës së identitetit të zj.***;
- Genplan i ndërtimit informal në posedim të zj.***, përgatitur prej ekspertëve *** dhe ***;
- Foto jashtë dhe brenda e ndërtimit informal të kryer prej zj.***.

Gjithë veprimtaria administrative e kryer deri më sot, prej organit që ju drejtoni, për shqyrtimin e vetëdeklarimit të kryer prej ankueses, pasqyrohet në aktet, shkresat, etj, si më sipër inventarizuar.

Bazuar sa më sipër si dhe përcaktimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.280, datë 01.04.2015, “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, të ndryshuar, ankuesja ka kërkuar dhe kërkon vazhdimin e procedurës së legalizimit për ndërtimin e saj informal, deri në nxjerrjen e aktit administrative përfundimtar (lejes së legalizimit).

Konstatohet se, ish-Drejtorja Rajonale e ALUIZNI-t, Tirana-Veri, sot Drejtorja Vendore e ASHK-së, Tirana-Veri, nuk ka kryer asnjë procedurë për shqyrtimin dhe përfundimin e veprimtarisë administrative të nisur më datë 29.12.2014, me rastin e administrimit të vetëdeklarimit të kryer prej ankueses zj.***.

Në shpjegimet tuaja, ju z.Drejtor, nuk keni prezantuar ndonjë shkak i cili do të mund të legjitimonte zvarritjen e përfundimit të procesit administrative të nisur më datë 29.12.2014. Në këtë kushte, gjykojmë se, është cënuar parimi për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, sikurse parashikuar në nenin 42/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, apo nenin 6/1 të Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut, ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me ligjin nr.8137, datë 31.07.1996.

=

Ish – Drejtorja Rajonale e ALUIZNI-t, Tirana-Veri, sot Drejtorja Vendore e ASHK-së, Tirana-Veri, nuk ka respektuar afatin ligjor për përfundimin e procedurës administrative sikurse parashikuar në nenin 49 të ligjit nr.8454, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar” në të cilin parashikohej kufiri kohor i procedimit administrative prej 3-muajsh, nga data e administrimit të kërkesës së palës të interesuar.

Nëse do të kishin ndodhur situata të veçanta, procedimi administrative do të përfundonte 3 muaj pas ndërprerjes së situatës së veçantë. Kjo situatë juridike është e mirëpërcaktuar në nenin 49 të “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar. Referimi për përfundimin e procedimit administrative në kufij të përgjithshëm kohor sikurse parashikuar në Kodin e Procedurave Administrative, kryhet për shkak, se, ligji nr. 9482, datë 03.04.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, nuk parashikon kufij kohor të përgjithshëm për përfundimin e procedurës administrative. Po kështu dhe ligji 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, i cili

ka shfuqizuar ligjin e lartpërmendur, nuk parashikon afat për legalizimin dhe regjistrimin në regjistrin publik të pasurive të paluajtshme, të ndërtimeve pa leje.

Kjo situatë ligjore e parashikuar në Kodin e Procedurave Administrative nuk rezulton e respektuar në procesin e shqyrtimit të vetëdeklarimit nr.3940, datë 29.12.2014, të kryer prej ankueses ***. Sipas dispozitave të ligjit nr.9482/206, *“Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”*, të ndryshuar, apo ligjit nr.202/2020, *“Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”*, ish-ALUIZNI, sot Agjensia Shëtitore e Kadastrës, për çdo vetëdeklarim për legalizim ndërtimi informal të paraqitur nga subjektet e ndryshëm pranë tij, është i detyruar të nxjerrë një, vendim, qoftë ky për legalizimin e ndërtimit informal, apo për përjashtimin e tij nga procesi i legalizimit.

Mospërfundimi i procedurës administrative për shqyrtimin e vetëdeklarimit të ankueses, nga 2014 e deri më sot, është fakt i cili vërteton, se, veprimtaria e Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t, Tirana-Veri, sot Drejtoria Vendore e ASHK-së, Tirana-Veri, nuk është zhvilluar në përputhje me legjislacionin në fuqi, jo vetëm për shkak të mosrespektimit, të parimit kushtetues për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, por dhe mosrespektimit të parimit të ligjshmërisë, përgjegjshmërisë, efikasitetit dhe deburokratizimit, transparencës, drejtësisë dhe paanësisë, në veprimtarinë e organeve publike.

Referuar objektit të kësaj ankese, Avokati i Popullit, sjell në vëmendje faktin, se, prej kohësh ka identifikuar si prioritet të punës së tij, trajtimin e ankesave dhe problematikave, që lidhen me cënimin e interesave pasurore të subjekteve pronarë, apo posedues të pasurive të paluajtshme, ardhur prej veprimeve, ose mosveprimeve të parregullta, apo të kundërligjshme të organeve përkatëse publike.

Veprimtaria e ish- Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t, Tirana-Veri, sot Drejtoria Vendore e ASHK-së, Tirana-Veri, në procesin e shqyrtimit të vetëdeklarimit të ankueses, subjekt vetëdeklarues i ndërtimit të saj informal, është në cënim të së drejtës themelore të njeriut për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor dhe në cënim të interesave pasurore të subjektit posedues të pasurisë së paluajtshme.

Nisur nga sa është përshkruar tashmë në komentin e nenit 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, një element i parimit të ligjshmërisë është edhe fakti që një organ public duhet të marrë vendime për rastet dhe çështjet nën kompetencën e tij ose që nuk duhet të shmang marrjen e vendimeve për kërkesat e paraqitura nga palët, nëse këto kërkesa janë nën kompetencën e tij.

Organe publike duhet të zbatojnë legjislacionin në fuqi për shkak të parimit kushtetues të shtetit të së drejtës. Organeve publike u ndalohej që të refuzojnë zbatimin e ligjit. Shteti i së drejtës është parimi mbizotërues për të gjitha veprimet administrative.

Në këtë këndvështrim, duam t’ju kujtojmë përkufizimin tashmë të pranuar nga Parlamenti Evropian, në lidhje me keqadministrimin nga ana e organeve të administratës publike, sipas të cilit:

“Keqadministrimi ndodh kur një organ publik, nuk vepron në përputhje me një rregull apo princip, i cili është i detyrueshëm për të”.

Në situatën juridike në të cilën ndodhet çështja, Avokati i Popullit, nisur nga parimi i zbatimit të ligjshmërisë, si dhe për një zgjidhje ligjore të këtij problem, e çmon me vend të dërgojë këtë rekomandim, duke shpresuar se kështu do të ndihmojmë bashkërisht për ndërprerjen e situatës së cënimit të parimit për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor. Për arsyet e përmendura, në përputhje me nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në të cilin sanksionohet, se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga administrate publike”*, si dhe parashikimit të kryer në nenin 21/b të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, *“Për Avokatin e Popullit”*, të ndryshuar, se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek orgni administrative që ka shkaktuar shkeljen”*,

REKOMANDOJMË

*“Përshpejtimin e procedurave dhe afateve të vendimmarrjes përfundimtare për shqyrtimin e vetëdeklarimit për legalizim nr.3940, datë 29.12.2014, të kryer prej ankueses ***”*.

Në përfundim të shqyrtimit të rekomandimit të dhënë, konformë parashikimit të kryer në nenin 19 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, *“Për Avokatin e Popullit”*, të ndryshuar, kthimi i përgjigjes të kryhet nga ana juaj brenda 30 ditëve nga data e dërgimit të kësaj shkrese.

Me besim në bashkëpunimin tuaj!

KOMISIONERI

Prof.Asoc.Dr. Erjona BANA(CANAJ)